



01 Nr. 455/24 Dt. 29.07.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e fillimit të procedurave për ofrimin e Shërbimeve konsulentë nëpërmjet marrëveshjeve për shërbime të veçanta (angazhim i konsulentëve) për nevojat e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për implementimin e projektit: “Ringjallja e Zejeve dhe Ndërtimi i Kulturës për Zhvillimin e Përbashkët të Turizmit” konform Marrëveshjes për Bashkëpunim, nr. 2022/434-320, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse, për angazhim (pranim) të dy konsulentëve:
 - 1.1. Një (1) do të jetë menaxher i projektit,
 - 1.2. Një (1) do të jetë bashkëpunëtor rajonal për turizëm.
2. Ky Vendim realizohet financiarisht nga buxheti i Komunës së Prizrenit-kodi buxhetor, nr. 92140.
3. Obligohet Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.

